

QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE

Matura Shtetërore 2020

Lënda: Filozofi dhe Sociologji

Tiranë 2020

Sociologji

1. Zbatimi i tabuve në kultura të ndryshme gjatë historisë bëhej i detyrueshëm, përmes: **1 pikë**
- A) forcës shtrënguese të shtetit.
B) **hyjnizimit të objektit të tabusë.**
C) marrëveshjeve mes kulturave.
D) lidhjeve ndërfishnore në shoqëri.
2. Rritja e shkallës së pavarësisë ekonomike dhe afirmimi i personalitetit të grave në shoqërinë bashkëkohore ndikon në: **1 pikë**
- A) rrallimin e divorceve.
B) pakësimin e konflikteve.
C) rregullimin e marrëdhënieve.
D) **rritjen e numrit të divorceve.**
3. Nëpunësi Y është inspektor mjedisi. Gjatë kontrollit për respektimin e rregullave mjedisore, shoqëria e inspektuar i ofroi si dhuratë një zarf me para, të cilat ai i pranoi. Ky veprim lidhet me formën e krimit: **1 pikë**
- A) "pa viktima".
B) kundër personit.
C) të **"jakave të bardha"**.
D) të mërisë dhe urrejtjes.
4. Një nga objektivat e lëvizjes feministe synon: **1 pikë**
- A) **tejkalimin e shtresëzimit gjinor.**
B) shtimin e përgjegjësisë të grave në mjediset shtëpiake.
C) rritjen e rolit të gruas në kujdesin ndaj anëtarëve të tjerë të familjes.
D) fuqizimin e figurës së gruas në dëm të ekuilibrit mes gjinive.
5. Kur studiuesi Ç. Kulej krahasonte shoqërinë me një pasqyrë, në të cilën njerëzit janë të aftë të përfytyrojnë veten sipas asaj se si të tjerët kundërpërgjigjen ndaj tyre, ai nënkuptonte se vetja jonë: **1 pikë**
- A) **përcaktohet nga reagimet e të tjerëve.**
B) është një "ishull" i izoluar nga të tjerët.
C) krijon shoqërinë në të cilën reflektohet.
D) nuk ndikohet nga veprimet e shoqërisë.
6. Përshkrime të kategorive të ndryshme të njerëzve të cilat vazhdojnë edhe përballë fakteve që i kundërshtojnë ato, në sociologji, vlerësohen si: **1 pikë**
- A) racizëm.
B) asimilim.
C) **stereotipa.**
D) diskriminim.
7. Feja budiste e shikon rrugën e shpëtimit të shpirtit në: **1 pikë**
- A) bindjen ndaj autoriteteve të fesë.
B) respektimin e ceremonive kolektive.
C) besimin tek një fuqi hyjnore e vetme.
D) **vetëdisiplinën dhe përkryerjen shpirtërore.**
8. Eklesia është organizatë fetare: **1 pikë**
- A) jozyrtare dhe e mirëintegruar në shoqëri.
B) zyrtare dhe jo e lidhur zyrtarisht me shtetin.
C) **zyrtare dhe e lidhur zyrtarisht me shtetin.**
D) e ndarë nga shteti dhe institucionet shoqërore.
9. Fatjona mbeti e habitur dhe e zhgënjyer, kur kolegu i saj, që vinte nga një vend i lindjes u përkul, por nuk ia zgjati dorën për ta përshëndetur. Kjo situatë lidhet me: **1 pikë**
- A) ksenocentrizmin.
B) **shokun kulturor.**
C) relativizmin kulturor.
D) ndërveprimin simbolik.
10. Sipas sociologut Gofman, në shumicën e rasteve, nofka përçmuese nxit tek individ i etiketuar: **1 pikë**
- A) **sjelljen deviante.**
B) zbatimin e ligjeve.
C) sjelljen konformiste.
D) respektimin e rregullave.
11. Gjatë periudhës disa shekullore të pushtimit të Shqipërisë nga Perandoria Osmane, kultura përparimtare shqiptare është zhvilluar si: **1 pikë**
- A) nënkulturë.
B) **kundërkulturë.**
C) kulturë sunduese.
D) kulturë tradicionale.

12. Forma e martesës, që i nje burrit të drejtën të ketë lidhje martesore me më shumë se një grua në të njëjtën kohë, quhet: **1 pikë**

- A) ekzogame.
- B) poliandria.
- C) poligjinia.**
- D) monogame.

13. Cili program i shkollës ndikon më shumë në shoqërimin e nxënësve? **1 pikë**

- A) Programi i hapur.
- B) Programi i fshehtë.**
- C) Kurrikula e detyruar.
- D) Rregullorja e shkollës.

14. Vlera kulturore më e spikatur në shoqërinë e sotme perëndimore është: **1 pikë**

- A) solidariteti.
- B) konformizmi.
- C) fryma kolektive.
- D) shpirti konkurrues.**

15. Në shoqërinë tradicionale shqiptare, zakoni i burrave për të ndërruar duhanin mes njëri-tjetrit, përcillte mesazhe të rëndësishme miqësie dhe barazie. Ky veprim lidhet më shumë me: **1 pikë**

- A) kundërkulturat.
- B) simbolet kulturore.**
- C) difuzionin kulturor.
- D) disfunktionet shoqërore.

16. Sipas pikëpamjes tradicionale, shekullarizimi përfaqëson një ndryshim të rëndësishëm, që lidhet me: **1 pikë**

- A) zbehjen e rolit të shkencës të bazuar në njohjen e arsyetuar.
- B) ruajtjen e besimeve fetare tradicionale përballë mendësive të reja.
- C) dobësimin e ndikimit dhe rolit të besimeve fetare në jetën e shoqërisë.**
- D) forcimin e ndikimit të organizatave fetare në veprimtarinë e organeve shtetërore.

17. Cili nga pohimet e mëposhtëm është i saktë? **1 pikë**

- A) Çdo deviancë është krim.
- B) Çdo krim është deviancë.**
- C) Asnjë nga deviancat nuk është krim.
- D) Asnjë nga krimet nuk është deviancë.

18. Sipas sociologut Xhorxh Herbert Mid, vetja shoqërore e individit është: **1 pikë**

- A) rrjedhje e përvojës shoqërore.**
- B) e lidhur me trupin si diçka biologjike.
- C) e pranishme që në lindjen e njeriut.
- D) një marrëdhënie instinktive me botën.

19. Në vitet 90-të, shtetasit shqiptar që emigronin për t'u integruar në Greqi, ndryshuan emrat, besimin dhe disa nga traditat kulturore. Kjo marrëdhënie e kësaj pakice kombëtare me shumicën në Greqi, quhet: **1 pikë**

- A) veçim.
- B) asimilim.**
- C) gjenocid.
- D) pluralizëm.

20. Cila nga format e mëposhtme të martesës, lejohet sipas legjisllacionit shqiptar në fuqi? **1 pikë**

- A) Poligjinia
- B) Poligamia
- C) Poliandria
- D) Monogamia**

21. Besimi se racat kanë më shumë ose më pak përparësi ose mangësi gjenetike në krahasim me njëra – tjetrën, përcaktohet si: **1 pikë**

- A) racizëm.**
- B) asimilim.
- C) stereotip.
- D) diskriminim.

22. Gjenocidi, si forma më e skajshme e racizmit, është quajtur dukuria e: **1 pikë**

- A) përshtatjes së anëtarëve të pakicave me modelet e kulturës sunduese.
- B) shpërfilljes dhe përcimit të grupimeve të caktuara racore dhe etnike.
- C) **zhdukjes së grupeve të popullsisë nëpërmjet përdorimit të dhunës.**
- D) veçimit fizik dhe shoqëror të racave dhe kulturave të ndryshme nga shumica.

23. Sipas fesë konfucianiste, shpëtimi vetjak mund të arrihet duke: **1 pikë**

- A) u bazuar në parimet vetjake që mbrojnë interesat e individit.
- B) qëndruar indiferent ndaj vuajtjeve dhe fatkeqësive të të tjerëve.
- C) ndërtuar jetën personale jashtë vlerave familjare dhe shoqërore.
- D) **jetuar brenda shoqërisë dhe në përputhje me virtytet morale.**

24. Cili nga vlerësimet kulturore, krijon kushtet më të favorshme për një fqinjësi të mirë ndëretnike? **1 pikë**

- A) Ksenofobia.
- B) Etnocentrizmi.
- C) **Relativizmi kulturor.**
- D) Paragjykimet stereotipike.

25. Njerëzit me ngjyrë të errët por nuancë të verdhë të lëkurës, shtat të zhvilluar mesatarisht dhe rrudhën "epicanthus" në cepin e syrit i përkasin racës: **1 pikë**

- A) europide.
- B) negroide.
- C) kaukaziane.
- D) **mongoloide.**

26. Cila nga format e mëposhtme të martesës, luan rol të veçantë në forcimin e marrëdhënieve ndërmjet grupeve të ndryshme shoqërore? **1 pikë**

- A) Poliginia
- B) Poliandria
- C) **Ekzogamia**
- D) Endogamia

27. Disa besime fetare pranojnë ekzistencën e një Zoti të vetëm në shpjegimin e dukurive natyrore e shoqërore, të cilat quhen fe monoteiste. Cili nga besimet e mëposhtëm i takon kësaj kategorie? **1 pikë**

- A) Budizmi
- B) Hinduizmi
- C) Paganizmi
- D) **Krishtërimi**

28. Në shkencat sociologjike është mirëpranuar përcaktimi i normave kulturore, si: **1 pikë**

- A) rregulla të hartuara dhe të miratuara nga organet përkatëse ligjvënese.
- B) sisteme simbolesh me kuptime të njësuara për komunikimin mes njerëzve.
- C) kritere të përgjithshme gjykimi për sjelljen e individëve të një shoqërie nga një tjetër.
- D) **rregulla të pashkruara ose të shkruara për drejtimin e sjelljes së anëtarëve të një kulture.**

29. Për studiuesit e etnografisë, romët në Shqipëri kategorizohen si pakicë: **1 pikë**

- A) **etnike.**
- B) fetare.
- C) klasore.
- D) kombëtare.

30. Mjaft studiues të huaj jo vetëm që nuk e kanë vlerësuar, por iu është dukur absurd, rituali tradicional i gjakmarrjes në kulturën shqiptare. Ky vlerësim lidhet me dukurinë e: **1 pikë**

- A) **etnocentrizmit.**
- B) ksenocentrizmit.
- C) relativizmit kulturor.
- D) ndërveprimi simbolik.

Filozofi

31. Në filozofinë e tij, Bergsoni theksonte se njohja njerëzore duhej bazuar në: **1 pikë**

- A) dijet e marra nga përvoja e shqisave.
- B) intuitën e njeriut si bazë e njohjes.**
- C) inteligjencën e shkëputur nga shqisat.
- D) riprodhimin e informacioneve të marra.

32. Filozofi Tales, mendonte se në themel të çdo gjëje qëndronte: **1 pikë**

- A) zjarri si logosi universal.
- B) atomet si grimca të pandashme.
- C) uji si substancë që transformohet.**
- D) numrat si rregull i strukturës kozmike.

33. Sipas filozofit Tomas Hobs, shteti lindi si: **1 pikë**

- A) marrëveshje mes sovranëve.
- B) kontratë shoqërore mes individëve.**
- C) shprehje e vullnetit të Zotit në tokë.
- D) bashkëpunim i qeveritarëve me popullin.

34. Karakteristikë për periudhën e Mesjetës është: **1 pikë**

- A) liria e mendimit filozofik dhe politik.
- B) dominimi i dijes shkencore mbi fenë.
- C) ndërthurja e filozofisë me teologjinë.**
- D) zhvillimi i dijes së vërtetë shkencore.

35. Në dallim nga rryma e empirizmit, filozofia racionaliste e bazon dijen tek: **1 pikë**

- A) teoritë fetare.
- B) arsyeja njerëzore.**
- C) përvoja e përditshme.
- D) eksperiencia e shqisave.

36. "Bota e ideve", sipas Platonit: **1 pikë**

- A) ekziston si një realitet material.
- B) është kopje e botës së sendeve.
- C) njihet përmes organeve të shqisave.
- D) përmban format ideale të sendeve.**

37. Filozofia politike e Kampanelës, e cila synonte të ndërtonte një shoqëri sipas modelit të "Qytetit të Diellit" u konsiderua si filozofi: **1 pikë**

- A) realiste.
- B) utopiste.**
- C) anarkiste.
- D) reformiste.

38. Thelbi i teorisë së Lokut për shtetin, lidhej me: **1 pikë**

- A) tolerancën dhe lirinë e besimit fetar.**
- B) nënshtrimin e qytetarëve ndaj pushtetit.
- C) pushtetin e padiskutueshëm të sovranit.
- D) kufizimin e të drejtave natyrore dhe civile.

39. Racionalizmi i Dekartit duket kur pohon se: **1 pikë**

- A) përvoja ndijore është baza e njohjes.
- B) njohja bazohet në arsyen njerëzore.**
- C) shqisat na japin informacionin e saktë.
- D) dija arrihet përmes përvojës së individit.

40. Sipas Rusoit edukimi i fëmijëve në shkollë realizohet përmes: **1 pikë**

- A) forcimit të disiplinës dhe rregullit.
- B) zhvillimit të prirjeve natyrore të secilit.**
- C) metodave autokratike dhe tradicionale.
- D) rritjes së rolit dhe autoritetit të mësuesve.

41. Kierkegard, si përfaqësues i ekzistencializmit në filozofi, e shikon burimin e lirisë njerëzore tek: **1 pikë**

- A) aftësia e individit për ndryshim.**
- B) rregullat strikte të moralit shoqëror.
- C) ndikimi i të tjerëve në jetën e çdo individit.
- D) sistemet e mbyllura dhe abstrakte të mendimit.

42. Në një nga provat e tij për ekzistencën e Zotit, Thoma Akuini pohon se: **1 pikë**

- A) sendet dhe dukuritë në botë lindin vetiu.
- B) asgjë në botë nuk ndodh asnjëherë pa shkak.**
- C) njeriu është qenie e domosdoshme nga vetvetja.
- D) fenomenet natyrore bazohen në ligjësi të brendshme.

43. Frojdi shpjegoi se psikika e njeriut, në pjesën më të madhe të saj, drejtohet nga: **1 pikë**

- A) arsyeja dhe racionalja.
- B) pavetëdija dhe instinktivja.**
- C) mbiuni dhe rregullat morale.
- D) problemet e përditshmërisë.

44. Filozofia sociale në Francë përfytyronte një shoqëri ideale, që do të bazohej në: **1 pikë**

- A) ruajtjen e funksioneve politike të shtetit.
- B) thellimin e ndarjes klasore të shoqërisë.
- C) dallimin mes punës mendore dhe asaj fizike.
- D) arsimimin dhe dëshirën për punë të njerëzve.**

45. Zhan Pol Sartri në idetë e tij mbi lirinë e individit, shprehet se: **1 pikë**

- A) zgjedhjet individuale imponohen nga ndikimi i shoqërisë.
- B) paraja dhe të mirat materiale janë vendimtare për lirinë e njeriut.
- C) njeriu është përgjegjës për zgjedhjet e veta në rrugën drejt lirisë.**
- D) fati i njerëzve vendoset nga një vullnet superior dhe i plotfuqishëm.

46. Metoda induktive e hulumtimeve filozofike nënkupton kalimin nga: **1 pikë**

- A) njohuritë e përgjithshme tek njohuria e veçantë.
- B) njohuritë e veçanta tek një njohuri e përgjithshme.**
- C) njohuritë e veçanta tek një njohuri tjetër e veçantë.
- D) njohuritë e përgjithshme tek një njohuri tjetër e përgjithshme.

47. "Vullneti për pushtet", sipas filozofit Fridrih Niçe, shpjegohet si: **1 pikë**

- A) bindja ndaj autoritetit të dogmave të kishës.
- B) pajtimi me sistemin tradicional të vlerave morale.
- C) besimi dhe shpresa në ekzistencën e një fuqie të mbinatyrshe.
- D) fuqia e brendshme e njeriut, për të tejkaluar të mirën dhe të keqen.**

48. Në filozofinë e lashtësisë, pamundësia e një kriteri universal për vlerësimin e moralit është tipar i: **1 pikë**

- A) stoicizmit.
- B) atomizmit.
- C) skepticizmit.**
- D) neoplatonizmit.

49. Cili nga filozofët e mëposhtëm e kushtëzonte hartimin e ligjeve nga klima, faktorët gjeografik dhe zakonet ku jetonte popullsia? **1 pikë**

- A) Kant
- B) Ruso
- C) Hjum
- D) Monteskje**

50. Në silogjizmin klasik të Aristotelit, nëse premisa e parë është: Të gjitha A janë B dhe premisa e dytë është: Të gjitha B janë C, atëherë konkluzioni është: **1 pikë**

- A) Të gjitha A janë C.**
- B) Të gjitha A janë D.
- C) Të gjitha D janë B.
- D) Të gjitha B janë A.

51. Logjika dialektike e Hegelit, pranon: **1 pikë**

- A) ndryshimin shoqëror jashtë proceseve historike.
- B) ekuilibrin natyror të dhënë njëherë e përgjithmonë.
- C) zhvillimin e shoqërisë si përplasje mes anëve të kundërta.**
- D) kriteret universale për vlerësimin e të vërtetave të përjetshme.

52. Sipas metafizikës së Aristotelit, çdo gjë që ekziston është: **1 pikë**

- A) pasojë e apeironit.
- B) kopje e botës së ideve.
- C) bashkekzistencë e atomeve.
- D) unitet i materies dhe formës.**

53. Një nga karakteristikat kryesore të shkollës së parë filozofike, e njohur si shkolla e Miletit, është:

1 pikë

- A) shpjegimi teologjik i botës.
- B) përqendrimi tek lumturia e individit.
- C) mbështetja tek fuqitë e mbinatyrshme.
- D) **shkëputja nga mitologjia për të shpjeguar botën.**

54. Logjika e shkollës së Epikurit i takon rrymës filozofike empiriste. Kjo do të thotë se njohja njerëzore:

1 pikë

- A) duhet të dyshojë tek të dhënat shqisore.
- B) **bazohet tek ndijimi dhe perceptimi shqisor.**
- C) është një rikujtim i shpirtit, i dijeve të harruara.
- D) mbështetet tek induksioni dhe analiza e ideve.

55. Në këndvështrimin e Plotinit, arsyeja e ekzistencës të së keqes në botë është:

1 pikë

- A) **mungesa e Njëshit.**
- B) arsyeja hyjnore.
- C) fati i paracaktuar.
- D) përplasja e të kundërtave.

56. Nënshtrimi i njerëzve ndaj fatit dhe mungesa e pasioneve, janë këshilla etike të:

1 pikë

- A) **stoicizmit.**
- B) skepticizmit.
- C) epikurianizmit.
- D) neoplatonizmit.

57. Në filozofinë e tij pragmatiste, Djui theksonte se edukimi në shkollë realizohet me sukses kur ai është:

1 pikë

- A) i mbështetur në parime teorike.
- B) **konkret dhe i lidhur me praktikën.**
- C) riprodhues i informacioneve të marra.
- D) autoritarist në metodat e mësimdhënies.

58. Një nga përfaqësuesit e stoicizmit romak, Mark Aureli, dha një kontribut më së shumti në:

1 pikë

- A) fizikë.
- B) logjikë.
- C) **politikë.**
- D) teologji.

59. Pyetja e Dekartit: "A ekzistoj unë?" shpreh:

1 pikë

- A) besimin tek njohja empirike.
- B) **frymën dyshuese ndaj gjithçkaje.**
- C) vlerësimin për metodën e induksionit.
- D) iluzionin e një konkluzioni përfundimtar.

60. Teoria e njohjes e Platonit, bazohet tek:

1 pikë

- A) logosi.
- B) ndijimet.
- C) emocionet.
- D) **reminishenca.**